



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr. 6637 / Prot
2

Kamëz, më 31/7 /2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore”; në Ligjin nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;

Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz, *shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin Kuzhinierë pranë Kopshut nr.21 “Univers” Laknas, Bashkia Kamëz*

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale, në momentin që aplikanti shpallet fitues:

1. CV;
2. Adresën e vendbanimit;
3. Dokumentin e identitetit;
4. Çertifikatën e gjendjes familjare dhe personale;
5. Dëftesën ose diplomën e shkollës shoqëruar me listën e notave (kopje të noterizuara)
6. Çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve dhe të specializimeve
7. Librezën e punës.
8. Librezën e sigurimit shëndetësor.
9. Vertetim Gjykatë
10. Raportin mjeko ligjor për aftësi në punë.
11. Vërtetim Prokurorie
12. Dëshmi e Gjendjes Gjyqësore.

Disa nga detyrat që duhet të kryejë kuzhinierja janë:

1. Zbaton menunë e miratuar sipas vakteve e grupmoshave.
2. Gatuan ushqime të pastra dhe me cilësi.
3. Respekton orarin e ngrënies për të gjitha grupmoshat e fëmijëve.
4. Ruan kampionet e ushqimit të përgatitur për 24 orë.
5. Mban pastër kuzhinën, mjetet e punës dhe të ushqimit.
6. Kalon rregullisht një herë në 6 muaj, kontrollin dhe ekzaminimet për t'u pajisur me librezë shëndetësore.
7. Merr informacion nga edukatorët për konsumin e ushqimit nga fëmijët.
8. Komunikon me prindërit për recetat ushqimore të fëmijëve me nevoja të vecanta.
9. Ruan ushqimet në kushte të përshtatshme dhe i servir ato sipas etikës së të ngrënit.
10. Njeh vlerat ushqimore të përbërësve të ushqimit të fëmijëve.
11. Mban në rregull dokumentacionin që lidhet me furnizimin me ushqime.

12. Bashkëpunon me Drejtuesen e Kopshtit për probleme që lidhen me cilësinë dhe peshën e ushqimeve që vijnë nga furnizimi.

Për pozicionin e punës si Kuzhinierë në Kopsht duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm dhe kurs kuzhine.
- Të ketë eksperiencë pune me grupmoshat (3-6 vjeç)

Dorëzimi i dokumentacionit do të kryhet me postë për Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në Bashkinë Kamëz brenda dates 15.08.2025

 **DREJTOR**
Aferdita Zefi



Romina Buzi
